



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2026

Lënda: Gjuhë shqipe

Udhëzime për nxënësin:

Testi ka **25 pyetje**.

Testi në total vlerësohet me **50 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Në pyetjet me alternativa qarkoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigje së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5a	5b	6	7	8
Pikë									
Pyetja	9	10	11	12	13	14a	14b	15	16
Pikë									
Pyetja	17	18	19	20a	20b	21a	21b	21c	22
Pikë									
Pyetja	23a	23b	23c	24	25a	25b	25c	25d	
Pikë									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Pjesa I

Kishte ardhur sërish pranvera, kur një mëngjes, nëpër mugëtirë, Kujtimi filloi të lëshonte me llastiqe kokrra kumbullash drejt dritares së dhomës ku flija bashkë me gjyshin. Gjeli i hallë Nafizes ende nuk kishte kënduar, dhe as kali i Hazis beut, për të cilin Bimi thoshte se kishte krahë të fshehtë që i nxirrte kur fluturonte, nuk ishte zgjuar ende. Ishin çastet e mrekullueshme kur e zeza e natës fillon t'i lërë vend blusë së errët të mëngjesit, si në peizazhet me yje të Van Gogut.

U shtira sikur po flija, kur im atë m'u afrua, më përkëdheli në flokë, pastaj më puti në ballë. Prita derisa ai u largua, pastaj dola nga dhoma për të kaluar nëpër degën e një hardhie para se gjyshi të ngrihej. Kujtimi më shikoi me dyshim.

-Hë, ta mban? - pyeti. - Pandeh se kam frikë? – ia ktheva me inat.

E ndoqëm kapitenin deri poshtë në rrugën kombëtare, ku ai u ngjiti në një autobus. Kishim ndonjë gjysmë ore që ecnim buzë rrugës kur dëgjuam uturimën e një motori. Ishte një kamion i ngarkuar me dërrasa. I ngritëm dorën, menduam se shoferi ndaloi për ne, por ai zbriti me një gjym në dorë dhe mbushi ujë në një kanal buzë rrugës. Ngriti mbulesën e motorit, që lëshonte tym e avull dhe e hodhi ujin në një grykë në formë hinke. Nxora nga xhepi një kartëmonedhë pesëlekëshe dhe iu luta të na merrte deri në Durrës. Shoferi pa ngarkesën. Na pyeti në rrinim dot mbi dërrasa. Nuk e zgjatëm.

Kamioni na la në një djerrinë pranë qytetit, ku kullotnin bagëtia. Durrësi i atyre viteve ishte ende i lidhur me fshatin. Kur hymë në rrugën që të çonte në port, e cila më vonë do të quhej Rruga Tregtare, gjetëm anash saj shtëpi të shkatërruara nga një tërmet i kohëve të fundit.

Sheshi i portit ishte mbushur me kamionë, karroca dhe mallra. Breguar anëve të saj qëndronin disa anije të vogla mallrash dhe një vapor i madh me flamur anglez. Unë nuk e njihja anijen e babait. I dija vetëm emrin: "Gloria- Lisën". "Hallall! - thoshin në fshat për të - Na paska vajtur emri nëpër dynja". Hamalli tha se ajo mund të nisej nga darka. Dolëm prapë nëpër qytet dhe unë prisha gjithçka që më kishte mbetur.

U detyruam të sorollateshim bregut të detit deri në të perënduar, kur puna në kalatën e portit u ndërpre dhe hamejtë filluan të largoheshin grupe- grupe. Iu afruam anijes "Gloria-Lisën", shkalla e së cilës vazhdonte të qëndronte ulur. Dy detarë mbërritën nga qyteti dhe u ngjiten në të. Nga biseda me disa burra të tjerë, që sapo kishin mbërritur nga udhëtimi, u kuptua se nisja nuk do të vononte. Fillova të dridhesha.

E përqafova dhe iu afrova anijes. Rrotull ishte errësirë. "Gloria- Lisën" ndriçohej zbehtë nga disa llamba të mbuluara nga pluhuri dhe bloza. Bëra sipër shkallës, por diku nga pjesa e përparme e anijes dëgjoheshin zëra burrash që bisedonin. Njoha zërin e tim eti. Zbrita sërish në tokë dhe sytë më shkuan te një litar i trashë lidhur në formë laku në një kalunë prej betoni. Litari vinte nga pjesa e pasme e anijes. "Vaporët nuk janë si kuajt, por ama i lidhkan njëllor si kuajt tek trungu i pemës,"- thashë me vete.

Isha duke u mbajtur i lumtur te timoni e duke imagjinuar sikur vaporit e çante detin me shpejtësinë e kalit të Hazis beut, kur babai hyri në kabinë i vrenjtur. Zbrita nga stoli dhe qëndrova para tij kokulur.

- Po kjo? - thirri kapiteni.- Ç'do të thotë kjo, mor kalama i mbrapshtë? A e di se unë jam nisur për në Venecia dhe deri atje më duhen katër ditë rrugë? Se më njoftuan në radio që pritet stuhitë? Pse ma bëre këtë?

- Bab, ti e di se nuk rri më dot në atë shtëpi.

- Do të rrih atje!

- Të lutem, më mbaj këtu! Unë mund të pastroj e laj anijen. Kam hyrë për 8 vjeç.

- Posi! Goxha burrë zotrote! Po shkolla? Nuk më duhet puna jote fare. Shko shpejt të hash diçka dhe të flesh gjumë, se do të të kthej për në Durrës!

Kur hapa portën e shtëpisë dhe u mata t'ia therja vrapit, toka sikur më bëri me rrënjë. U ndala. Më pushtoi mallëngjimi. I përkëdhela me dorë dërrasat e vjetra të portës, ku ende dalloheshin gjurmë të vizatimeve të mia me qymyr, pastaj rashë në gjunjë, putha pragun dhe u largova duke qarë. "Më fal gjysh! Edhe ti kapiten!- mërmërita. - Nuk qe faji im."

Fragmente të shkëputura nga romani "Djali që shikonte detin" Viktor Canosinaj.

Fjalor

Kalatë :mol, skelë portuale

Gjym: Enë bakri a llamarine, me fund të gjerë e me grykë të ngushtë që përdoret zakonisht për të mbajtur ujin.

1. Çfarë i shtyn fëmijët të ndërmarrin këtë udhëtim? **1 pikë**
 A) Të përballen me sfida që do t'i ndihmojnë të rriten.
 B) Të zbulojnë një të vërtetë të fshehtë për të kaluarën e tyre.
 C) Të kërkojnë mundësi të reja dhe të ndryshojnë jetën e tyre.
 D) Të sfidojnë veten dhe të zbulojnë më shumë për botën përreth.
2. Imazhet e natyrës “e zeza e natës dhe blusë së errët të mëngjesit” përcjellin: **1 pikë**
 A) pamjen kur natyra ndryshon gjatë ditës.
 B) kontrastin e fortë mes natës dhe mëngjesit.
 C) mbresën e pashlyeshme të pikturës së Van Gogut.
 D) qetësinë e natyrës dhe pasigurinë që mund të ndodhi gjatë ditës.
3. Gjendja emocionale e personazhit kryesor gjatë këtij udhëtimi është: **1 pikë**
 A) i gëzuar dhe i qetë pas çdo zbulimi.
 B) i sigurt dhe optimist për të ardhmen.
 C) i frikësuar, i pasigurt dhe i mallëngjyer.
 D) i lodhur dhe i ndarë nga realiteti.
4. Figura letrare e përdorur në fjalinë: “Vaporët nuk janë si kuajt, por ama i lidhkan njëlloj si kuajt tek trangu i pemës.”, është: **1 pikë**
 A) metaforë.
 B) krahasim.
 C) përsëritje.
 D) personifikim.
5. **1 pikë**
 a) Gjeni në paragrafin e parë, një detaj që lidh botën reale me atë imagjinare. **1 pikë**

 b) Zbuloni dy momentet kyç të rrëfimit, që shënojnë fillimin dhe mbarimin e udhëtimit të personazhit. **2 pikë**
 Momenti i fillimit:
 Momenti i mbarimit:
6. Gjeni dy cilësi të djalit që shfaqen gjatë vetërrëfimit të aventurës së tij. **2 pikë**
 1) 2)
7. Djali i thotë babait “kapiten”. Çfarë tregon kjo mbi afërsinë dhe rolin e tij në familje? **1 pikë**

8. Në fund të fragmentit, djali prek dërrasat e portës. Çfarë tregon ky imazh për marrëdhënien e tij me vendin dhe kujtimet e fëmijërisë? Ilustroni përgjigjen tuaj me fjali nga teksti. **2 pikë**

Pjesa II

Gentiana, bima me fuqi antibiotike, që zbuloi mbreti Gent.

Historia e zbulimit të bimës *Gentiana* është po aq befasuese sa edhe fuqia e saj shëruese. Gjatë sundimit të mbretit Gent, Iliria u përfshi nga një epidemi e rëndë murtaje. Vdekshmëria mes banorëve ishte aq e lartë, sa që mbreti shpalli një periudhë lutjesh. Sipas legjendës, gjatë kësaj kohe ai hodhi një shigjetë në ajër, duke besuar se vendi ku do të binte ajo do të tregonte burimin e shërimit.

Shigjeta ra mbi disa barishte, të cilat rezultuan të pasura me aftësi kurative për të ndaluar përhapjen e sëmundjes. Kur kjo bimë u testua më vonë, u vërtetua se kishte veti të jashtëzakonshme medicinale dhe se ndihmoi ndjeshëm në pakësimin e vdekjeve nga murtaja. Që prej asaj kohe, ajo u quajt *Gentiana*, në nderim të mbretit Gent, lutjet e të cilit, sipas besimit popullor, çuan në zbulimin e përbërësve të saj shërues.

Ky zbulim ishte një nga arsyet që, kur mbreti Gent u zu rob, ai nuk u vra, por u dërgua në Romë. Në mjekësinë moderne, emri i kësaj bime lidhet edhe me një antibiotik me veprim antibakterial, të quajtur *Gentamicin*, i cili ka shfrytëzuar potencialin e saj kurativ.

Figura e mbretit Gent është përjetësuar edhe në kartëmonedhën shqiptare me vlerë 2000 lekë. Kjo kartëmonedhë përfaqëson një nga personalitetet më domethënëse të historisë ilire, të përzgjedhur nga Banka e Shqipërisë. Në anën e pasme të saj paraqitet bima medicinale me emrin botanik *Gentiana lutea*, duke lidhur kështu historinë kombëtare me trashëgiminë natyrore.

Gentiana lutea është një bimë barishtore shumëvjeçare, e cila rritet nga 1 deri në 2 metra lartësi. Ajo ka gjethe eliptike, me gjatësi 10–30 cm dhe gjerësi 4–12 cm, ndërsa lulet janë të verdha dhe përbëhen nga shtatë petale. Bima rritet zakonisht në mjedise alpine dhe kullota nënalpine, kryesisht në toka gëlqerore.

Rrënja e saj është e trashë, me disa degëzime, dhe korret në vjeshtë për t'u tharë dhe ruajtur për përdorim të mëvonshëm. Rrënjët e bimëve që nuk kanë lëshuar lule janë veçanërisht të pasura me përbërës kurativë, ndaj përdoren më shpesh në mjekësi.

Gentiana ka një reputacion të gjatë si tonik natyral. Ajo ndihmon tretjen e ushqimit dhe është përdorur si në mjekësinë popullore, ashtu edhe në atë moderne. Përbërësit e saj gjenden kryesisht në rrënjë, por edhe në pjesët e tjera të bimës, dhe shërbejnë si ilaç tonik, antifungal dhe antifungicid, pra kundër mykut të njeriu dhe të bimët. Për këtë arsye, rrënjët e saj janë bërë pjesë e preparateve farmaceutike.

Një veçori e dallueshme e *Gentianas* është shija e saj jashtëzakonisht e hidhur. Ajo ruan hidhësinë edhe kur hollohet deri në 58.000.000 herë me ujë, duke u renditur ndër substancat natyrore më të hidhura të njohura. Kjo veçori është përdorur si bazë shkencore për matjen e shkallës së hidhërimit dhe gjen zbatim të rëndësishëm në industrinë farmaceutike. Përveç kësaj, në industrinë e kozmetikës, *Gentiana* përdoret për efektet e saj antioksiduese dhe rigjeneruese për lëkurën.

Fragment i shkëputur nga gazeta "Molla e shëndetit" Qershor 2014

9. Emri *Gentamicin* lidhet me bimën *Gentiana* sepse:

1 pikë

- A) përmban rrënjë të thata të *Gentiana luteas*.
- B) ka shfrytëzuar potencialin kurativ të kësaj bime.
- C) është përdorur tradicionalisht nga ilirët si ilaç popullor.
- D) është prodhuar për herë të parë në Evropë nga ekstraktet e saj.

10. Cila veçori botanike e *Gentiana luteas* e dallon atë nga shumë bimë të tjera barishtore?

1 pikë

- A) Rritet në toka ranore dhe klimë të thatë.
- B) Lulëzon vetëm një herë gjatë gjithë ciklit jetësor.
- C) Ka gjethe të gjata dhe të ngushta me ngjyrë të errët.
- D) Arrin deri në dy metra lartësi dhe është bimë barishtore shumëvjeçare.

11. Qëllimi kryesor i përdorimit të *Gentianas* si standard shkencor për matjen e hidhësisë është:

1 pikë

- A) krahason shijen e saj me produkte të tjera natyrore.
- B) përcakton nivelin e hidhërimit në pije dhe produkte kozmetike.
- C) vëzhgon reagimin e organizmit ndaj substancave shumë të forta.
- D) siguron një bazë të qëndrueshme matjeje për përbërësit aktivë të barnave.

- 12.** Udhërrëfyesi turistik flet para vizitorëve për mbretin Gent dhe *Gentianën*. **1 pikë**
Cila fjali është më e përshtatshme për t'u treguar ngjarjen dhe t'u tërheq vëmendjen vizitorëve?
A) A e dini se si u zbulua kjo bimë shëruese?
B) *Gentiana* përdoret si antifungal në mjekësi.
C) *Gentiana* ka rrënjë të trashë dhe degëzime të shumta.
D) Sipas legjendës, mbreti Gent hodhi një shigjetë dhe shpëtoi popullin nga murtaja.
- 13.** Identifikoni dy veçoritë e mjedisit ku u gjet bima *Gentiana*. **2 pikë**
Iartësinë dhe tipin e tokës:
bimët që e rrethojnë:
- 14.**
a) Pse Banka e Shqipërisë ka vendosur figurën e mbretit Gent dhe bimën *Gentiana lutea* në kartëmonedhë? **1 pikë**
.....
b) Si ndikojnë tek lexuesi përdorimi i fakteve dhe të dhënave shkencore për fuqinë shëruese të *Gentianës*? **2 pikë**
Jepni një ilustrim nga teksti.
Interpretimi:.....
Ilustrimi:.....
- 15.** Ju punoni në sektorin e reklamave të një kompanie farmaceutike. **2 pikë**
Ndërtoni një reklamë për shitjen e një prej produkteve natyrale të nxjerrë nga bima *Gentiana*.
.....
.....
.....
- 16.** Në titullin: "*Gentiana, bima me fuqi antibiotike, që zbuloi mbreti Gent*". **1 pikë**
Presja pas fjalës *Gentiana* shërben për të:
A) matur hidhërimin e përbërësve aktivë.
B) drejtuar vëmendjen te zbatimet praktike.
C) ndarë emrin e bimës nga shpjegimi i saj.
D) treguar shijen e hidhur në pije dhe produkte kozmetike.
- 17.** Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar gabim në tekst? **1 pikë**
A) qëndër.
B) hidhësinë.
C) e shkurtër.
D) së tmerrshme.
- 18.** Trajta e saktë e grupit emëror, *elementin e fundit të përzgjedhur*, në numrin shumës është: **1 pikë**
A) elementet e fundit të përzgjedhur.
B) elementit të fundit të përzgjedhur.
C) elementet e fundit të përzgjedhura
D) elementeve të fundit të përzgjedhura.
- 19.** Cila nga grupet e fjalëve të mëposhtme ka përcaktor me bashkim? **1 pikë**
A) Lutjet e të cilët çuan.
B) Që prej asaj kohe u quajt.
C) Përbëhen nga shtatë petale.
D) Do të tregonte burimin e shërimit.

20.

- a) Gjeni temën fjalëformuese dhe prapashtesën e mbiemrit
- befasuese*
- .

2 pikë

Tema fjalëformuese:

Prapashtesa:

- b) Emërtoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë e mëposhtme.

2 pikë

Rrënjët e bimëve që nuk kanë lëshuar lule janë veçanërisht të pasura me përbërës kurativë, ndaj përdoren më shpesh në mjekësi.

që: ndaj:

21.

- a) Po përgatiteni të prezantoni një
- tekst informues për bimën Gentiana*
- para shokëve.

1 pikë

Ndërttoni një *fjalë të qartë dhe të plotë*, ku të përdorni mbiemrin “*të njohura*” në *shkallën krahasore të barazisë*.

Fjala duhet të përmbajë një informacion të dobishëm për këtë bimë.

.....

- b) Identifikoni vetën dhe rasën e përemrit të nënvizuar në fjalinë: “
- Lutjet i sollën shfaqjen hyjnore të përbërësve të saj medicinalë.*
- ”

2 pikë

Veta:

Rasa:

- c) Në fjalinë: “Një lloj antibiotiku, që për herë të parë u
- zbulua
- në Amerikë.”, në cilën mënyrë dhe kohë është folja e nënvizuar.

2 pikë

Mënyra:

Koha:

22. Udhërrëfyeni turistik dëshiron të përcjellë emocion dhe habi të vizitorët kur flet për bimën
- Gentiana*
- .

Fjalinë dëftore: “*Është një nga komponimet më të hidhura natyrore të njohura deri sot.*”, kthejeni në *fjalë dëftore thirrmore*, të përshtatshme për komunikim.

2 pikë

.....

23.

Gjeni kryefjalën në fjalinë: “Kjo barishte kishte veti të habitshme medicinale.”. Tregoni me se shprehet.

2 pikë

Kryefjala:

Shprehet me:

- a) Dalloni kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë në fjalinë e dhënë.

“Të cilit lutjet i sollën shfaqjen hyjnore të përbërësve të saj medicinalë.” Shkruani me se shprehet.

2 pikë

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë:

Shprehet me:

- b) Qarkoni grupin foljor ku folja
- jam*
- është përdorur si ndërtues i kallëzuesit foljor.

1 pikë

...janë edhe më të pasura në përbërës kurativë.

...janë bërë pjesë e preparateve farmaceutike.

24. Cila nga fjalitë e përbëra i përgjigjet skemës së dhënë?

1 pikë

A) Kohë më vonë, u gjet që kjo barishte kishte veti medicinale.

B) Ky zbulim ishte shkaku që kur u zu rob, mbreti Gent nuk u vra.

C) Historia e zbulimit të kësaj bime është po kaq befasuese sa fuqia e saj.

D) Shija vjen aq e hidhur, edhe nëse hollohet.

Pjesa kryesore**Pjesa e varur I****Pjesa e varur II**

Pjesa III**6 pikë****25. Të shkruarit**

Gjatë vizitës në Muzeun Kombëtar, ju vizituat pavijonin e historisë së Ilirisë. Ciceroni po ju tregon legjendën e mbretit Gent, i cili zbuloi bimën Gentiana dhe shpëtoi popullin nga murtaja. Kjo bimë përdoret edhe sot në mjekësi dhe kozmetikë.

Shkruani një ese argumentuese ku të argumentohet rëndësia e bimës Gentiana dhe të theksohet roli i udhëheqjes së mbretit Gent në kapërcimin e situatave të ndërlikuara historike.

Në esenë tuaj, përfshini:

- Veprimi i mbretit Gent tregon shembullin e një udhëheqësi të përgjegjshëm.
- Përdorimi i Gentianës në mjekësi dhe trashëgimi kulturore tregon rëndësinë e bimëve medicinale dhe lidhjen mes traditës dhe shkencës.
- Shfrytëzoni fakte nga teksti dhe shpjegoni pse ato janë të rëndësishme.

Shtjellimi i idesë (25a)	Struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (25d)	Totali 25
2 pikë	1 pikë	1 pikë	2 pikë	6 pikë

